



www.lezha.gov.al

bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, i përmuajshëm, Nr. 2, qershor 2017

Plazhi Rana e Hedhun – Destinacion i preferuar turistik



Ujësjetlësi i ri, ujë pa ndërprerje, fq 4




Qendër e re për shëndetin e gruas, fq 12



Kuvendi i Troshanit, Monument kulture, fq 17



Sporti - një sezon plot medalje, fq 22



përmbajtja

Mblidhet Këshilli Bashkiak i Lezhës	4
Ujësjiellësi i ri, ujë pa ndërprerje	4
Ri-integrimi i fëmijëve emigrantë	5
Hapësire e re publike multifunkionale në Lezhë	6
Mirëmbajtja e infrastrukturës së qytetit	7
Linjat rrethqytetëse, oraret dhe stacionet e tyre	8
Thatësira, situatë problematike me zjarret	10
Fëmijët me aftësi ndryshe, kamping	12
Lezhjanët mysafirë të Sofrës Iliro-Dardane	13
'RANA E HEDHUN', RRËSHQITËSE ME PLASMAS	14
Plazhi i Shëngjinit, fluks i madh pushuesish	16
TALJA , ATRAKSIONI ME I RI TURISTIK	17
Sporti - një sezon plot medalje	18
Investitorë të bujqësisë nga Izraeli në Lezhë	19
Lezha feston	20

Redaksia

Drejtoria e Integrimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit
 Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri
 Fotot: Olsi Tetaj
 Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj
 Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli
 www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al

Mbledhet Këshilli Bashkiak i Lezhës

Nën drejtimin e Kryetarit Kristian Gjiodaj është mbledhur Këshilli Bashkiak i Lezhës i cili me shumicë votash ka miratuar projekt-vendimin për dhënie e ndihmës ekonomike familjeve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar. Si pasojë e konfliktit gjyqësor me ish-drejtesit e mëparshëm funksionimi i këshillit kishte krijuar probleme, e për pasojë dhe dhënia e ndihmës ekonomike ishte shtyrë për tre muaj. Kreu aktual i Këshillit Bashkiak Lezhë Z.Gjiodaj, gjyqin e fituar e quan një shkrimje ngërçi të veprimtarisë ligjore të këtij forumi, i cili me vendimet që do miratojë do të ndihmojë në zgjidhjen e problematikave për qytetarët e Lezhës dhe të njësive të tjera administrative. Në fund, nga Këshilli Bashkiak i Lezhës u bë miratimi i vendeve vakante, ku dy anëtarët e rinj të këtij Këshilli, Ndrej Gazulli dhe Petrit Ndrej bënë betimin.



Ujësjellësi i ri, ujë pa ndërprerje

Për herë të parë zonat turistike të Lezhës do të furnizohen me ujë të pishëm pa ndërprerje. Kështu garanoi Drejtori i Ujësjellës-Kanalizimeve Z. Zef Maçi në Lezhë i cili garanton që janë marrë të gjitha masat që uji i pishëm të mos mungojë në të gjithë Bashkinë, ndërsa thotë që nuk do të ketë rritje të çmimit. Investimi i ri ka prekur Lezhën, Ishullin e Lezhës, Ishullin e Shëngjinit dhe Balldrenin. Me furnizimin e ri të gjithë banorët e këtyre zonave do të furnizohen 24 orë me ujë të pishëm. Nuk ka rritje çmimi me ujësjellësin e ri. Tarifat do të jenë të njëjta me ato që kemi patur, por padyshim që ka edhe debitorë.

Ata duhet të paraqiten pranë drejtorisë së UKL për të mësuar debitë e tyre si dhe modalitetet për shlyerjen e kësaj debie, e cila mund të bëhet edhe me marrëveshje apo me këste. Gjatë sezonit turistik kërkesa për furnizim me ujë rritet, sidomos në zonën e shëngjinit. “Gjatë muajit korrik numri i pushuesve në këtë zonë arrin deri në pesëdhjetë mijë persona në ditë” tha z. Maçi.



Ri-integrimi i fëmijëve emigrantë të kthyer në Lezhë

Bashkia Lezhë, konkretisht sektori i Kujdesit Social po bashkëpunon që prej një viti me organizatën Terre des homes për një projekt mbi përmirësimin e kushteve të jetesës për ri-integrimin e fëmijëve emigrant në Shqipëri. Projekti synon të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme kushtet e jetesës për fëmijët vulnerabël në bashkinë e Lezhës, për të parandaluar përfshirjen e tyre në emigracionin e pasigurt dhe për të lehtësuar ri-integrimin e atyre që janë kthyer nga emigracioni, duke përmirësuar aksesin tek shërbimet cilësore sociale, përfshirë edukimin, edukimin profesional dhe mundësi për të gjeneruar të ardhura. Gjithashtu ky projekt ka qëllim të fuqizojë ekonomikisht këto familje vulnerabël duke i mundësuar krijimin e një biznesi të vogël ku ata mendojnë se janë të aftë të punojnë dhe si pasojë familjet të nxjerrin të ardhura e të përballojnë jetesën që mos të lindë nevoja të nxjerrin në emigrim fëmijët e tyre.

Konteksti i ndërhyrjes: Në Shqipëri, është rritur varfëria nga 12.4% në 2008 në 14.3%, ku 20.1% e fëmijëve jetojnë në varfëri absolute. Emigracioni i fëmijëve të pashoqëruar, sidomos të atyre me origjinë romë, nga Shqipëria drejt BE-së është një çështje shqetësuese. Në 2013. Numri i kërkesave për azil të depozituar nga shtetasit shqipëtar në 28 shtete anëtare të BE-së arriti 31.240 nga 434,450 kërkesa në total. Fëmijët përbënin më shumë se çerekun e të gjitha këtyre kërkesave, me një rritje të të miturve të pashoqëruar që udhëtonin drejt vendeve të BE-së dhe kërkonin mbrojtje. Në total janë bërë 60.220 kërkesa për azil nga shtetasit shqipëtar në BE gjatë 2015, nga të cilat 33.5 % ishin të mitur.

Që nga muaji prill 2016 që ka filluar projekti e deri më tani, janë trajtuar rreth 25 familje. Këto familje ndihmuar konkretisht me; paketa ushqimore, veshëmbathje, orendi shtëpiake, kurse profesionale dhe krijimin e bizneseve të vogla. Projekti do të zgjasë deri në prill 2018 dhe çdo ditë po identifikohen familje që të përfshihen.



Një hapësirë e re publike multifunkionale në Lezhë

Kohë më parë hapësira perballë gjimnazit “Hydajet Lezha” në qytetin e Lezhës ishte kthyer në një vatër mbeturinash dhe njëherësh strehë për disa familje të komunitetit rom dhe egjiptian të cilat jetonin në keto baraka pa kushtet minimale të banimit. Për t’i kthyer këto mjedise në hapësira publike, fillimisht Bashkia largoi këto familje rome duke i sistemuar në banesa me kushte optimale për jetesë. Anëtarët e këtyre familjeve shprehën mirënjohje për Bashkinë e Lezhës dhe kreun e saj Z.Fran Frrokaj, që u bëri të mundur një mënyrë jetese më të denjë. Menjëherë pas strehimit të familjeve rome Bashkia nisi nga puna për sistetimin e këtyre hapësirave me destinacion në lulishte, kënde lojrash për fëmijë dhe parkim autoveturash, duke u bërë dhe financuese e këtij projekti me



vlerë 22 milion lekë. Sot këto mjedise u janë kthyer qytetarëve dhe kanë një tjetër pamje nga ato që kanë qënë kohë më parë. Intelektuale dhe qytetarë të Lezhës shprehin vlerësim për punën e bërë nga Bashkia dhe kreu i saj Z.Frrokaj. Ata njëherësh sfidojnë paragjykimet dhe hamendësimet e të painformuarve se çdo gjë që po bëhej këtu ishte planifikuar të betonizohej për pallate shumëkatëshe. Lulishtja me kënde lojrash për fëmijë dhe parkim automjetesh ia ka shtuar akoma më shumë hijëshinë këtij blloku të ri banimi nga ku po zgjerohet e zbukurohet Lezha e re. Shtimi i hapësirave publike e mosrurdhja e tyre me ndërtime pa kriter janë prioritet i Bashkisë Lezhë, e cila me politikën e saj mjedisore e urbane punon për rritjen e cilësisë së jetës të komunitetit qytetar.



Sektori i Shërbimeve mirëmban dhe zgjeron infrastrukturën e qytetit

Në Sektorin e Shërbimeve puna është përqëndruar kryesisht në mirëmbajtjen e rrugëve, sidomos në qytet dhe në zonat turistike, Shëngjin, Kune e Tale, por pa ndërprerë punën edhe në qendrat e tjera të banuara. Gjithashtu një rëndësi të madhe kanë patur edhe riparimet e kanalizimeve të ujërave sipërfaqësore, të cilat ishin kthyer në një shqetësim në disa zona, ku shpesh kishin krijuar probleme duke prishur edhe rrugët. Me gjithë punën e mirë që ka kryer ky sektor, përsëri, mungesa e fondeve për të blerë materiale të ndryshme si: tulla apo bitum për riparimin e rrugëve, na kanë vënë në vështirësi për të mundësuar infrastrukturën e domosdoshme që kërkon një destinacion turistik me frekuentim të lartë.

Gjatë muajit të fundit, Sektori i Shërbimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë ka ndërmarrë një aksion për të kryer ndërhyrje në ndërtesat që rrethojnë Sheshin “Gjergj Kastrioti” duke përmirësuar fasadat e godinave të institucioneve. Fasada e ndërtesës së zyrave qendrore të institucionit të Bashkisë ka përfunduar e para së rikonstruktuar, ku krahas rikonceptimit të fasadës janë kryer edhe punësime të brendshme për t’ia përshtatur godinën nevojave të institucionit që rrjedhin pas reformës Administrative-territoriale. Më pas është vijuar me lyerjen e Bibliotekës së Qytetit, fitueses së praktikës më të mirë në rang kombëtar për angazhimin komunitar, duke e kthyer kështu në një gjendje normale pasi kjo ndërtesë nuk ishte lyer asnjëherë qëkur është ndërtuar dhe si pasojë e kësaj, ngjyra ishte venitur shumë. Në ditët e fundit të korrikut punëtorët e shërbimeve janë zhvendosur tashmë në ndërtesën e Pallatit të Kulturës



në të cilin po ashtu nuk është bërë ndërhyrje që prej ndërtimit të tij. Të gjitha këto ndërtesa priten të jenë gati për aktivitetet e “Lezha Feston” që fillon me datë 5 gusht dhe vazhdon për thujse gjithë muajin gusht. Në vendndodhjen e ish-gjimnazit të vjetër po punojmë për ndërtimin e një qendre komunitare në bashkëpunim me organizatën World Vision që na ka mundësuar bazën materiale.

Gjithashtu grupi i elektrikistëve të Sektorit të Shërbimeve, krahas mirëmbajtjes rutinë të sistemeve të ndriçimit publik ekzistues kanë instaluar sisteme ndriçimi publik edhe në qendrat e fshatrave Tresh, Pllanë, Zejmen, Merqi si dhe kanë zgjeruar sistemin e qytetit të Lezhës edhe në rrugën “Vellezerit Coku”. Një problem i veçantë doli gjatë kësaj periudhe për vaditjen e lulishteve pasi vënia në funksion e sistemit të ri të ujësjellësit nxorri jashtë funksionit linjat e vaditjes. Në këto kushte sipërmarrja e gjelbërimit për të normalizuar situatën ka bërë hapjen e dhjetë puseve në mënyrë që të kryhet vaditja e këtyre lulishteve në mënyrë të vazhdueshme duke garantuar një ambient të gjelbër në funksion të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Linjat rrethqytetëse, oraret dhe stacionet e tyre

Bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Lezhë vendosi miratimin e linjave rrethqytetëse si dhe linjave shtesë për sezonin e plazhit së bashku me stacionet përkatëse.

LINJAT RRETHQYTËSE EKZISTUESE, ME KËTO ORARE

Nr.	Linja	Nisja`	Kthimi	Frekuenca
1	Lezhë – Shëngjin	0600 - 2000	0630 – 2030	Çdo orë
2	Shëngjin - Lezhë	0630 – 2030	0630 – 2030	çdo orë
3	Lezhë – Blinisht	0720 , 0800 , 0900 , 1030 , 1100 , 1130 , 1330 ; 1430 dhe 1600	0630; 0700; 0745; 0800; 1000; 1100; 1345; 1430 dhe 1530	
4	Lezhë – Kallmet	0600 - 2000	0500 – 1900	çdo orë
5	Lezhë – Dajç	0720 , 0830 , 0930 , 1115, 1200 , 1300 , 1400 dhe 1630	0600; 0700; 0830; 1000; 1200; 1345; 1500 dhe 1730	
6	Lezhë – Zejmen (Pllanë)	0600 - 2000	0500 – 1900	çdo orë
7	Lezhë – Gjadër	0600 - 1800	0500 – 1900	çdo orë
8	Lezhë – Balldre - Torovicë	0600 - 1800	0530 – 1730	çdo orë
9	Lezhë – Ungrej	0600 , 0700 , 0800 , 1200, 1300, 1500 , 1600	0530; 0700; 0900; 1100; 1200; 1330 dhe 1500	
10	Lezhë – Shënkollë	0600 - 2000	0630 – 2030	çdo 1/2 orë
11	Lezhë – Barbullojë	0600 - 1800	0630 – 1830	çdo 1/2 orë

STACIONET E LINJAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

- Në anë të rrugës nacionale Lezhë-Shkodër, sa kalon rrotundon pranë Urës së Mikpritjes së Lezhës, në përfundim të vendqëndrimit të taksive 8+1; do të jenë stacionet e linjave, sipas rradhës së mëposhtme:
 - Stacioni i linjave Lezhë-Pukë dhe Lezhë-Fushë Arrës
 - Stacioni i linjës Lezhë-Shkodër
 - Stacioni i linjave Lezhë-Blinisht dhe Lezhë-Dajç
 - Stacioni i linjës Lezhë-Gjadër
 - Stacioni i linjës Lezhë-Balldre-Torovicë
 - Stacioni i linjës Lezhë-Velipojë
- Në sheshin poshtë lokal “Panorama”, tek rondo pranë Urës së Mikpritjes së Lezhës, do të jetë stacioni i linjës Lezhë-Shëngjin dhe stacioni i kthimit për linjën Shëngjin-Lezhë. Për sezonin turistik edhe poshtë Gurrave, te fillimi i rrugës së “Shëlbuevit”
- Në fillim të rrugës së Kallmetit, pranë pallatit të oficerave, do të jetë stacioni i linjës Lezhë-Kallmet.
- Në rrugën “Frang Bardhi”, përballë memorialit të vend-varrimit të Heroit Kombëtar, do të jetë stacioni i linjave Lezhë-Ungrej dhe Lezhë-Vau i Dejës.
- Pranë Urës së Cenit, do të jetë stacioni i linjës Lezhë-Shënkollë.
- Në rrugën “Vëllezërit Coku”, përtej qendrës tregtare “NET-CENTER”, do të jetë stacioni i linjës Lezhë-Barbullojë.
- Në rrugën e Shtrausit, pranë urës së Cenit, do të jenë stacionet e linjave Lezhë-Laç, Lezhë-Peshkopi dhe Lezhë-Kukës.
- Në rrugën “Papa Gjon Pali II”, pranë Katedrales Katolike, do të jenë stacionet e linjave Lezhë-Tiranë dhe Lezhë-Durrës
- Poshtë gurrave, përballë karburant “Elda”; do të jenë stacionet e linjave Lezhë-Rrëshen dhe Lezhë-Zejmen.

LINJAT SHITESË, VETËM PËR SEZONIN TURISTIK, NGA 15 MAJI DERI ME 30 SHTATOR

Nr.	Linja	Nisja`	Kthimi
1	Gjadër-Shëngjin	0900 , 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
2	Dajç-Shëngjin	0900 , 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
3	Blinisht-Shëngjin	0900 , 1000 dhe 1200	1700 , 1730 dhe 1800
4	Kallmet-Shëngjin	0900 , 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
5	Zejmen-Shëngjin	0900 , 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
6	Balldre – Shëngjin	0900, 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
7	Ungrej - Shëngjin	0900, 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
8	Manati - Shëngjin	0900, 1000 dhe 1200	1700 , 1800 dhe 1900
9	Lezhë-Ishull Lezhë	0600 – 1800; çdo orë	0500 - 1700; çdo orë

Thatësira krijon situatë problematike me rënien e zjarreve

Drejtorja e Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave në bashkëpunim me Drejtorinë e MZSH-së, Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjore dhe Zhvillimit Rural, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Policia Bashkiake, Komisarati i Policisë Vendore etj., në zbatim të detyrave në funksion të rritjes së sigurisë publike, ruajtjes së pronës dhe mjedisit etj, ka hartuar Planin e Masave për Parandalimin dhe Përballimin e situatave emergjente që krijohen gjatë stinës së verës që krijohet nga zjarret në sipërfaqe pyjore, kullota, parqe, plantacione pemtarie, pika furnizimi me karburant, etj., për vitin 2017.

Në këtë plan masash janë përcaktuar masat dhe detyrat konkrete që do të merren dhe zbatohen nga të gjithë aktorët ose forcat pjesëmarrëse në operacionet për parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga fatkeqesi natyrore, sikurse është zjarri, si dhe nga fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria e njerzore.

Megjithatë punën e bërë dhe masat e marra gjatë muajit korrik në territorin e Bashkisë Lezhe kemi patur 43 rënie të zjarreve me permasa të ndryshme, ku me problematike kanë qenë vatrat e zjarreve në malin e Manatise, Torovices, Dragushes, Berzanes, etj, ku është rrezikuar jeta e banoreve dhe e banesave, por me nderhyrjen e Sherbimit të MZSH-se, Emergjencave Civile, Agjensisë të Sherbimit Pyjor, Forcave speciale të Ushtrisë dhe vete banoreve është bërë e mundur që këto zjarre të shuhen plotësisht duke siguruar jetën e njerëzve dhe pronën e tyre, përveç djegies të një banese të braktisur dhe e amortizuar në Torovice mbas riaktivizimit të zjarrit në orën 14:50 dt.17.07.2017, vater e cila ishte shuar me pare në orën 13:20 të kësaj dite, si dhe djegia e një banese tjetër, theksojmë se problematika që sjell levizja në terrenin malor dhe pamundësia e shuarjes së zjarrit në malin e Manatise ku nderhyrja e forcave të Sherbimit të MZSh-se ishte e pamundur, përveç forcave kembesore perfshire edhe ato të ush-

trisë, nga drejtuesi i operacionit lokal në bashkëveprim me Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhe kanë kërkuar nderhyrjen nga ajri për shuarjen e zjarrit me helikopter. Për këtë na është venë në dispozicion (ndonese me vonese) një helikopter në orën 15:20-15:55 të dt.17.07.2017 i cili ka bërë tre fluturime duke luftuar zjarrin nga ajri me ujë. Në Manati, në datën 16.07.2017, rreth mesnatës, stafi i emergjencave civile në bashkëpunim me Polinë e Shtetit fillimisht kanë kryer evakuimin e 20 banorëve të rrezikuar nga zjarri si dhe të gjësë së gjallë (30 krerë, gjithashtu edhe një stan me rreth 150 krerë dhi). Me normalizimin e situatës, u asistua në kthimin e banorëve në banesat e tyre.

Në të gjitha rastet e rënies së zjarrit Policia e Shtetit ka qenë prezente në kqyrjen e vendngjarjeve dhe vazhdimin e procedurave perkatese sipas objektit të punës së tyre. Gjatë operacioneve për shuarjen e zjarrit në shumicën e rasteve e sidomos në vatrat e zjarreve problematike, me gjithë njoftimet e bera ka rezultuar se njesite vullnetare për shuarjen e zjarreve të organizuara në cdo fshat nuk ka funksionuar sic duhet. Idiferentizmi i njerëzve, qëndrimi i tyre si spektator edhe kur rrezikohej jeta e banoreve, banesave, pronës dhe kur po digej masivi i pyjeve me pisha, shkurre dhe ferra nuk ka sens dhe nuk duhet të ketë tolerancë nga askush.

Dhe në ditët në vazhdim, mbas një periudhe të gjatë pa reshje shiu, thatësira të madhe dhe temperaturave të larta, perseri rreziku i rënies së zjarrit është evident, gjë që kërkon nga të gjitha forcat e gatshme (forcat operacionale) si dhe nga cdo shtetas i Bashkisë tone, të forcojmë vrotimin duke mbajtur në monitorim të vazhdueshëm situatën, në mënyrë që për cdo rast të mireorganizohemi në kohë rekord për të vepruar shpejt në kapjen e situatave duke rritur shkallën e bashkëpunimit në kryerjen e veprimeve me shpejtësi e saktësi në përballimin dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente, si në fazën fillestare edhe gjatë dinamikës së zhvillimit të tyre.



Fëmijët me aftësi ndryshe në kamping te Rana e Hedhun

Rana e Hedhun në Shëngjin të Lezhës është plazhi ku prej tri vitesh Fondacioni imzot Luçiano Avgustini në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, Caritasin e Dioqezës së Sapës dhe grupe vullnetarësh, organizojnë kampingje 10-ditore për fëmijët me aftësi ndryshe. Gjithçka bëhet për këta fëmijë është mbi baza vullnetarizmi. I gjithë stafi përgjegjës, me plot durim, përkujdesje e dashuri po u shërben atyre për t'u krijuar mundësi optimale ushqyerjeje, pushimi, argëtimi e riaftësimi. Ata po përjetojnë gëzueshëm jetën në këtë kamping. Prindërit e fëmijëve me aftësi ndryshe shprehin mirënjohje për përkujdesjen dhe trajtimin që u bëhet atyre. Vullnetarët, mësues të edukimit fizik, psikologë dhe trajnues të tjerë shprehin kënaqesinë dhe përkushtimin për shërbimin ndaj këtyre shtresave. Edukimi muzikor është një tjetër aspekt i veprimtarisë ditore të këtyre fëmijëve. Drejtori i Caritasit të Dioqezës së Sapës, Nikolin Lekaj falenderon Fondacionin Luçiano Avgustini dhe të gjithë ata që mundësuan funksionimin e këtij kampingu për fëmijët me aftësi ndryshe. Gjatë çdo sezoni veror turistik në këtë kamping trajtohen mbi 150 fëmijë me aftësi të kufizuara. Plazhi, noti, loja me topin dhe ushtrimet gjimnastikore riaftësuese janë pjesa më e rëndësishme e aktivitetit ditor në kamping. Bashkia e Lezhës ju ka krijuar këtyre fëmijëve lehtësira në përzgjedhjen e hapësirës publike të plazhit Rana e Hedhun. Përkushtimi, durimi, përkujdesja dhe dashuria e ekipit vullnetar që po punon për argëtimin, riaftësimin dhe integrimin e këtyre fëmijëve mbeten pika më kulmore e bamirësisë dhe humanizmit njerëzor.



Lezhjanët mysafirë të Sofrës Iliro-Dardane

Në datat 10-11-12 Qershor, Unioni Artistik i Kombit Shqiptar organizoi Edicionin e 15-të të "Sofrës Iliro-Dardane" në stadiumin e lojrave me dorë të qytetit B.Curri, aty ku ky festival nisi rrugëtimin e tij 15 vjet më parë.

Sipas Azgan Haklajt, Drejtues i Unionit Artistik të Kombit Shqiptar ka disa arsye themelore për të cilat u zgjodh Tropoja si mikpritëse e "Sofrës Dardane": "Arsyeja e parë është historiko-geografike: Tropoja është jo vetëm udhëkryq luftërash dhe mejdani i tyre për Liri e Mëvetësi në shekuj, por dhe qendër e një trekëndëshi të sakatuar etnik, që i lidh trojet kombëtare Iliro-Dardane, të Shqipërisë, të Kosovës e të Malit të Zi."

Në këta vite ky eveniment ka krijuar traditën e vet të mrekullueshme, duke u kthyer në një sofër bu-

jare ku mblidhen artistë nga të gjitha trevat shqiptare. Me qindra artistë, me dhjetra ansamble dhe grupe kulturore kanë mbushur rrugët e Tropojës dhe podiumin e festivalit, duke manifestuar në fakt integrimin e përbashkët kulturor të shqiptarëve, pasi tradita dhe folku shqiptar ka shtruar tashmë një urë të çeliktë mes qyteve shqiptare në cilëndo anë të kufijve. Me mijëra spektatorë plot entuziazëm përcollën për tre net interpretimin me mjeshtri të lartë artistike të artistëve.

Rapsodet Lezhjanë Pavlin Kola e Arben Pacani ishin grupi i cili hapi naten e III-te këtij edicioni me një këngë kushtuar mikpritjes dhe kësaj sofere si dhuratë nga Lezha. Grupi i Lezhës u falenderua dhe u vlerësua me certifikatë pjesëmarrje për Rapsodët dhe qytetin e Lezhës.



'RANA E HEDHUN', RRËSHQITËSE ME PLASMAS

Super adrenaline e dhuruar nga Specialistet e Sportit ne Bashkine Lezhe Klajti Niazi Reçi dhe Pergjergji Altin. Keshtu e pershkroi ABC NEWS kete risi tek Rana e Hedhun. Kush do te jete aktiviteti i radhes?



Pas prezantimit me sukses të garave me kajak në lumin që përshkon qytetin e Lezhës, sektori i sportit në DAKTS ka nisur improvizuar një rreshqitëse me ujë në pjerrësinë e Ranës së Hedhun e cila është kthyer në një destinacion tejet interesant për fundjavën e 22-23 korrikut për pushesit e Shëngjinit dhe për rininë e qytetit të Lezhës.

Asnjëherë më parë ky plazh nuk kishte patur një frekuentim kaq të madh nga turistët, duke bërë kështu që të arrihet synimi që DAKTS kishte, promovimi i një destinacioni të ri nëpërmjet një aktiviteti të veçantë.

Duke përfituar nga karakteristikat e terrenit të Ranës së Hedhun, specialistët e sportit kanë krijuar me mjete rrethanore dhe pa shumë shpeenzime një rampë për rrëshqitje prej 40 metrash, e cila është furnizuar rregullisht me ujë me anë të një pompe.

"Jam një adhuruese e sporteve ekstreme ishte një nga eksperiencat më të bukura në Shqipëri" shprehet një turiste e huaj. "Ishte një eksperiencë e lezetshme do të provoja sërish"

"Mendua të sjellim dicka të re për pushuesit. Një sport ekstrem në Lezhë kjo është dicka e re në mënyrë që sa më shumë pushues të vijnë këtu" shprehet Reçi. Klajti Reçi dhe Altin Pergjergji, specialistë të Sportit në këtë drejtori thanë se tashmë synimi i tyre është jo vetëm që t'u ofrojnë turistëve mundësi të reja argëtimi, por edhe të krijojnë mundësi të reja për shfrytëzimin e aseteve që Zoti ja ka falur Lezhës me kaq bujari.



Plazhi Rana e Hedhun – Destinacion i preferuar turistik

Asfaltimi i rrugës për te Rana e Hedhun e ka sjellë këtë plazh, unikal në llojin e tij, më afër pushuesve vendas dhe të huaj. Janë operatorët turistikë të kësaj zone bregdetare që kanë investuar në asfaltimin e këtij aksi rrugor me gjatësi 3 km, i cili sezonet e tjera turistike ishte mjaft i vështirë për t'u përshkuar pasi gropat, pluhuri dhe dëmtimi i automjeteve ishin një ankth për të apasionuarit e këtij plazhi. Plazhi Rana e Hedhun është një nga zonat turistike më të veçanta jo vetëm në Lezhë, por edhe në shkallë vendi. Ai është piketuar si plazh me destinacionin më tërheqës turistik. Si në asnjë plazh tjetër, në këtë peisazh bregdeti magjepsës që të ofron qetësi e bukuri të rradhë, rrinë fare pranë mali me gjelbërimin e pyjeve dhe deti me ujin e pastër dhe rërën kurative. Ata që zgjedhin pjesën fundore të Shëngjinit, ku shtrihet pikërisht zona mbresëlënëse e ranës së hedhun janë pushues vendas por edhe turistë që vijnë kryesisht nga Kosova,



Mali i Zi, Maqedonia dhe shtete të tjera të Bashkimit European. Megjithëse vite më parë ky bregdet ka qënë krejtësisht i panjohur për pushuesit dhe turistët, rana e hedhun po përmbush më së miri të gjitha pritshmëritë e atyre që kanë guxuar të udhëtojnë drejt kësaj zone, të cilën, si të rriturit ashtu edhe të rinjte, e konsiderojnë unike dhe tepër tërheqëse për ta. Plazhin e Ranës së Hedhun e kanë bërë më të frekuentuar për pushuesit investimet private me lokale komode të ngritura në mesin e gjelbërimit të pishave, fare pranë detit, ku shërbehet në mënyrë korrekte e me çmime tepër të favorshme. Bashkëpunimi biznes privat – Bashki, si në pastrimin, rregullin, qetësinë dhe menaxhimin korrekt e ligjor të hapësirave publike të plazhit ia ka shtuar vlerat kësaj zone të virgjër turistike. E konsideruar si një zonë unike në rajon, Rana e Hedhun në Shëngjin ka zgjuar interesin e një numri të madh pushuesish.



Plazhi i Shëngjinit pushtohet nga një fluks i madh pushuesish

Shëngjini, qyteti me destinacion turistik, ka hapur portat për mijëra pushues që kanë mbipopulluar bregdetin e këtij plazhi aq të preferuar nga vendasit dhe të huajt. Ditët me shumë diell, rëra kurative me hapësirën e pafundme, uji dhe mjedisi i pastër me infrastrukturën hoteliere të standarteve të avancuara e kanë bërë këtë sezon qytetin e Shëngjinit strehën e adhuruar të Adriatikut. Fluksi i pushuesve është rritur më shumë gjatë ditëve të korrikut. Receptionet e hoteleve flasin për dyndje të madhe turistësh dhe kërkesa të shumta për prenotime të reja. Sipas statistikave, këtë muaj, krahasuar me një vit më parë, numri i turistëve ka qënë 30% më i lartë. Në fundjavë në plazhin e Shëngjinit kanë hyrë mbi 45 mijë pushues të ardhur nga rrethe të ndryshme të vendit, por më së shumti dhe nga Kosova, Ma-

qedonia, Mali i Zi, Italia, Anglia, Çekia e shtete të tjera. Rritja e këtij fluksi është rezultat edhe i masave që ka marrë Bashkia Lezhë në furnizimin 24 orë pa ndërprerje me ujë të pijshëm, energji elektrike, në krijimin e rregullt, pastërtinë dhe garantimin e qetësisë publike në mjedisin e plazhit. Kompleksi Ermiri për këtë sezon ka vënë në dispozicion të tyre dhoma plazhi me kapacitet 500 shtretër. Për t'u krijuar turistëve e të rinjëve një pushim sa më atraktiv e relaksues, në pistat e bregdetit organizohen veprimtari argëtuese që përmbushin dëshirat dhe pritshmëritë e tyre. Në këtë mënyrë turizmi bregdetar në Plazhin e Shëngjinit, duke u mbështetur tek standartet më të avancuara të kësaj industrie me rëndësi ekonomike, po merr një zhvillim të ri që premtion akoma më shumë në të ardhmen e afërt.



TALJA, ATRAKSIONI ME I RI TURISTIK

Plazhi i Tales në Lezhë është kthyer në atraksionin turistik më të ri të kësaj vere, duke tërhequr një numer të madh pushuesish. E mundëson këtë hapësira e madhe e këtij plazhi me gjatësi 12 km dhe gjerësi rëre mbi 100 m, e shtrirë mes grykëderdhjeve të dy lumenjve, Drin dhe Mat. Plazhi i Tales, gradualisht po plotëson gjithë kërkesat dhe pritshmëritë e frekuentuesve, numri i të cilëve në fundjavë arrin deri në 40 mijë pushues ditor. Infrastruktura rrugore, shërbimet e përmirësuara, qetësia, çmimet tepër të favorshme dhe mbi të gjitha pastërtia e ujit dhe e rërës kurative, janë arsyt kryesore që e bëjnë plazhin e Tales si vendin ideal për të kaluar pushimet e sezonit të verës. Përmirësimi i kushteve ka bërë që ky plazh 3-4 vitet e fundit të tërheqë vëmendjen e pushuesve të shumtë vendas dhe të huaj, mjaft prej të cilëve vijnë nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe shtete të tjera europiane. Pushuesit e ardhur në këtë plazh, që në fillim të sezonit janë shprehur të kënaqur për kushtet e ofruara dhe masat e marra nga Bashkia Lezhë dhe Njësia Administrative e Shënkollit në drejtim të përmirësimit të rrjetit infrastrukturor turistik. Për Qarkun e Lezhës plazhi i Tales është kthyer në një nga destinacionet më të preferuara turistike të këtij sezoni. Si pushuesit vendas dhe ata të huaj kanë mbetur të befasuar për atë çfarë u ofron plazhi i Tales dhe largohen prej tij me dëshirën për t'u rikthyer sërish.



Sporti - një sezon plot medalje



Me datë 1 Qershor, në Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve i gjithë stadiumi i qytetit u mbush nga nxënës të shkollave, sportistë dhe artistë të vegjël. Kjo ditë shënoi edhe ndarjen e certifikatave për dhjetëra nxënës të dallur në fusha të ndryshme të shëncave. Gjithashtu u dhanë certifikata për sportistët e dalluar në sporte të ndryshme për rezultatet e tyre të larta, ku spikati Z. Luigj Vataj, i cili ka nderuar qytetin tonë me medalje ballkanike për moshat U 15 në sportin e Judos me trajner Altin Përgjergji. Kryetari i Bashkisë Z.Fran Frrokaj i uroi të gjithë fëmijët për ditën e tyre dhe i falenderoi për punën e palodhur që kanë bërë për të arritur rezultate pozitive, duke theksuar se Bashkia Lezhë do të bëjë maksimumin që të përkrahë këta talente si dhe do të ndihmojë në zbulimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të talenteve të rinj. Ndër rezultatet më pozitive për sportistët Lezhjanë këtë sezon mund të përmedim ekipin e futbollit të akademisë "Porto" me grupmoshat U 15, me trajner Klajti Reçi, të cilat kanë arritur të dalin në finalen e kupës. Gjithashtu disa certifikata u shëprndanë edhe për ekipet e tjera ku Lezha ka nxjerrë kampionë kombëtarë

si në Mundje, Karate, Kick-Boxing, Taekëon-Do, si pas kategorive.

Lezha është një qytet me traditë në sporte ndeshëse, një popull që e don sportin, të rinj që duan të shprehin talentin e tyre në disiplina të ndryshme. Lezha e historisë, e kulturës dhe e traditës sportive, përveç sporteve tradicionale si futbollit, voljebollit apo mundja, vitet e fundit ka njohur disa sporte luftarake që janë pëlqyer shumë nga brezat e rinj. Që në vitin 1991 në vendin tonë erdhën disa sporte marciale, ndërsa në Lezhë erdhën pak më vonë, rreth viteve 97-98. U pritën pozitivisht nga të rinjtë, sportet si Judo, Karate të cilat kanë nxjerrë disa gjenerata kampionësh dhe medaljesh, si dhe u frekuentuan nga shumë të rinj e të reja të qytetit tonë. Pak më vonë erdhën dhe sporte të tjera si Taekëon-Do, Kick-Boxing, një risi për qytetin tonë. Klubi shumë sportesh në Lezhë na ka dhuruar disa herë kënaqësi duke ncxjerrë kampionë në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, por për rezultate më të mira ka ende nevojë për mbështetje, sidomos për përmirësimin e terreneve sportive, dhe krijimin e kushteve të talenteve për stërvitje të vazhdueshme.

Dita botërore kundër punës së fëmijëve



Në kuadër të Ditës Botërore Kundër Punës së Fëmijëve bashkia Lezhë në bashkëpunim me shoqata dhe institucione që veprojnë në qytet dhe njësitë e tjera administrative organizuan një takim sensibilizues kundër shfrytëzimit dhe punës së fëmijëve. Në këtë aktivitet u përcollën mesazhe që kishin të bënin me shkëputjen e fëmijëve nga rruga, mos shfrytëzimin në punë, shkollimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. Shpesh herë pre e këtij fenomeni kanë rënë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian. Ndaj u theksua në takim se, është mjaft i domosdoshëm kontributi i pushtetit vendor, i shkollave, shoqatave e organizatave të ndryshme që afrojnë shërbime direkte në parandalimin e viktimave që mund të bien pre e fenomeneve të tilla. Shenjat që tregojnë se fëmijët apo të rinjtë janë rekrutuar duke rënë viktimë të punëve të rënda, vjedhjes, krimeve, të lypurit në rrugë dhe shpërndarjes së drogës, duhet të jenë sinjale alarmi për çdo qytetar, shoqatë dhe institucion shtetror.

Investitorë të bujqësisë nga Izraeli në Lezhë



Kryebashkiaku i Lezhës z.Fran Frrokaj priti një grup investitorësh nga Izraeli. Në qendër të diskutimit ishte bashkëpunimi në fushën e bujqësisë kryesisht, apo edhe në infrastrukturë. Një ndër specialistët dhe biznesmenët më të fuqishëm në fushën e agrikulturës, që ka bërë emër në Izrael dhe në europë, z.Tamir Hamami, shprehu interes për krijimin e fermave për prodhime të ndryshme bujqësore. Kreu i Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj për kulturën e shalqinit i sugjeroi investim në fushën e Torovicës, mjaft e përshtatshme në kultivimin e kësaj kulture, ndërsa për kultura të tjera bujqësore i propozoi toka në zonën e Zadrimës, Zejmenit, Bregut të Matës etj. Frrokaj u zotua se bashkia do të jetë e gatshme në plotësimin e aspektit ligjor dhe krijimin e mundësive për investitorët e huaj dhe ata izraelit.

LEZHA FESTON

festa e verës gjallëron gushtin në qytet

“Lezha Feston”, aktiviteti që Bashkia Lezhë do të organizojë për disa ditë rresht, si një festë që sjell argëtim për të gjithë qytetarët, emigrantët, vizitorët dhe turistët. Çdo gjë nis më 5 Gusht në qender të sheshit “Gjergj Kastrioti” deri më 20 gusht 2017. Festa do të përfshijë aktivitete artistike e kulturore ndërsa do të kulmojë më 15 Gusht, Ditën e Shtegtarëve.

Bashkia Lezhë fton të gjitha bizneset apo të interesuar të tjerë që duan të marrin pjesë në këtë nismë të paraqesin kërkesen e tyre për pjesmarrje deri më date 30 korrik 2017. Kërkesa dorëzohet pranë Drejtorise së Arsimit, Turizmit, Kulturës e Sportit ku dhe do të njiheni me të gjitha detajet mbi detyrimet që Bashkia Lezhë do ketë karshi biznesit dhe anasjelltas.



Ju mirëpresim!



Këto ditë festive janë një mundësi më shumë për zhvendosjen e pushuesve dhe turistëve nga bregdeti drejt Lezhës duke krijuar alternativa më shumë për argëtimin e tyre. “Lezha Feston” është konceptuar që të realizohet në sheshin “Gjergj Kastrioti” të qytetit nga data 5 Gusht deri me 20 Gusht, ku do të vendosen biznese shërbimit, ndërsa Drejtorja e Arsimit, Turizmit, Kulturës e Sportit do të merret me zhvillimin e aktiviteteve gjatë mbrëmjeve. Menaxhimi i aktivitetit do të jetë pjesë e bashkisë duke bërë edhe konsultimet e nevojshme me bizneset që do të vendosen në këtë shesh. Gjatë këtyre ditëve do të ketë aktivitete artistike dy herë në javë me artistë të muzikës, ndërsa do të kulmojë me 15 Gusht në Ditën e Shtegtarëve ku do të rritet ndjeshëm cilësia artistike e aktivitetit. Për të qenë pjesë e sheshit gjatë ditëve të “Lezha Feston”, bizneset duhet të përmbushin këto detyrime:

1. Të kenë shtëpizë druri apo të ngjashme me to për vendosjen e banakut.
2. Hapësira do t’u përcaktohet nga ana e bashkisë në përputhje me bizneset e tjera.
3. Të rregullojnë ambjentin e tyre.
4. Të paguajnë energjinë elektrike të konsumuar prej tyre sipas fuqisë elektrike të instaluar.
5. Të vendosin kosha për hedhjen e mbeturinave si dhe largimin e mbeturinave.
6. Të sigurojnë vetë ujën e pijshëm për përdorim.

7. Të paguajnë ruajtjen nëpërmjet policisë private gjatë kohës që nuk ka aktivitet.
 8. Të paguajnë bashkarisht shumën që do të kërkohet për realizimin e aktiviteteve.
 9. Të përballojnë bashkarisht aktivitetin festiv për 15 gushtin “Dita e Shtegtarëve”
 10. Pagesa për energjinë elektrike do të bëhet me dy këste dhe me parapagim.
 11. Pagesa për eventet artistike do të bëhet një ditë para zhvillimit të tij
 12. Pagesa për ruajtjen do të bëhet parapagim, ose duke e dakortësuar vetë me policinë private
- Per realizimin e aktivitetit Lezha feston, Bashkia Lezhë do të kontribuojë me:

1. Sheshi administrativ do t’u jepet bizneseve pa qera.
2. Punonjësit e shërbimeve do të jenë në ndihmë për lidhjet e nevojshme elektrike.
3. Do të mundësojë banjot publike gjatë zhvillimit të aktivitetit
4. Policia bashkiake do të jetë në dispozicion për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit.
5. Drejtorja e Arsimit, Turizmit, Kulturës e Sportit do të merret me mbarëvajtjen e aktiviteteve artistike.
6. Bashkia Lezhë do të sigurojë për aktivitetet e ndryshme, skenën, fonin dhe ndriçimin.



Bashkia Lezhë,
Lagjia Skënderbeg,
Sheshi "Gjergj Kastrioti",
4501, Lezhë,
info@lezha.gov.al
www.lezha.gov.al